



Oendra e Trajnimeve & Burimeve për Avokim

# AVOKUESI



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

Perkrah

komunitetin e OJQ-ve



Vëllimi V • Numri 1 • Janar 2007

## Qeveria për, shoqëria civile kundër ndërtimit të termocentralit të ri në Kosovë

### PËRMBAJTJA

#### Faqe 2

Banka Botërore në Kosovë shpalli programin e granteve të vogla për vitin 2007

"Avokimi në praktikë të përkrah barazinë në mes njerëzve"

Dy OJQ të Ferizajit formojnë koalicion për demokratizim

Pensionistët kërkojnë zgjidhje urgjente për gjendjen e tyre sociale

#### Faqe 3

Pallati i Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë të shërbej për nevojat e të rinjve

Qeveria dhe shoqëria civile diskutuan për kthimin e familjeve të zhvendosura në Kastriotit

Shoqëria civile të ngrit vetëdijen e qytetarëve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

### Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së: [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

Rr. Agim Ramadani Nr. 15  
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë  
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244 810

Përfaqësues të Ministrisë së Energjetikës dhe Minierave (MEM), Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (MAPH), partive politike në opozitë dhe shoqërisë civile janë takuar më 19 janar në ATRC për të diskutuar planet e qeverisë për ndërtimin e një termocentrali të ri në komunën e Kastriotit. Në këtë debat publik, të organizuar nga ATRC-ja, u shtrua pyetja "termocentrali i ri Kosova C - zhvillim ekonomik apo ndotje e ambientit?"

Që kur qeveria është përfshirë në ndërtimin e termocentralit të ri më 2006, është kritikuar sidomos nga ambientalistët.

Përfaqësuesit e qeverisë të pranishëm në debatin e ATRC-së, Ardian Gjini - Mi-

nistër i Ambientit dhe Agron Dida - Zëvendës Ministër i Energjetikës, pohuan se ky projekt është i domosdoshëm për zhvillimin ekonomik në Kosovë. Ministri Gjini deklaroi se termocentrali i ri do të ulte nivelin e ndotjes së ajrit.

Përfaqësuesit e partive në opozitë dhe shoqërisë civile shprehën skepticizmin e tyre. Ata argumentuan se termocentrali është projekt i vjetër i viteve të 70-ta dhe do të ketë ndikim negativ për ambientin. Komuna e

Kastriotit është një ndër zonat më të ndotura në rajon, thotë Nazif Shala, zyrtar për çështje të ambientit në këtë komunë.

"Niveli i ndotjes së ajrit në Komunën e Kastriotit është 400 herë më i lartë se sa që lejohet me standardet e BE-së", ka deklaruar Nazif Shala.



Termocentrali në Kastriot, Kosovë

## ATRC-ja publikoi kalendarin e trajnimeve për vitin 2007

ATRC-ja do të vazhdoj t'i përkrah OJQ-të gjatë vitit 2007 përmes trajnimeve, dhënies së granteve dhe shërbimeve për informim. Programi i trajnimeve do të përfshijë trajnime dhe konsultime bazike dhe të avancuara për zhvillim organizativ, menaxhim, avokim, shtim të fondeve dhe marrëdhënie me media.

ATRC-ja në janar publikoi kalendarin e trajnimeve për vitin 2007. Trembëdhjetë trajnime janë paraparë të

zhvillohen për shkrimin e projekt propozimeve, menaxhimin e projektit, menaxhimin e OJQ-së, hyrje në avokim dhe ndërtim koalicioni, qeverise të mirë, komunikim marketing, rolin e OJQ-ve në shoqëri, dhe marrëdhëniet OJQ-media. (Vizito [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org) për datat e trajnimeve.)

Trajnimet e ATRC-së janë falas për OJQ-të kosovare të regjistruara në ATRC. OJQ-të mund të regjistro-

hen duke shkarkuar dhe plotësuar Formën e Regjistrimit, e cila ndodhet në web faqen e lartpërmendur.

Përmes trajnimeve, ATRC-ja synon t'u ofroj OJQ-ve teknikat dhe ekspertizën e nevojshme për të zhvilluar potencialin e tyre dhe për t'i realizuar qëllimet strategjike në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.

Për më shumë informata, kontaktoni 038 244 810 ose [training@advocacy-center.org](mailto:training@advocacy-center.org).

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

*Dialogu social***Pensionistët kërkojnë zgjidhje urgjente për gjendjen e tyre sociale**

Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Kosovës (SPPIPK) u ka bërë thirrje institucioneve qeverisëse ta shqyrtojnë me seriozitet gjendjen e tyre. "Pensionistët nuk mund të mbijetojnë me 40€ në muaj", kanë deklaruar ata. Pensionistët përsëritën kërkesën e tyre për reformim të pensioneve gjatë një tryeze të rumbullakët të organizuar më 16 janar nga SPPIPK-ja, përkrahur nga ATRC-ja.

*Koalicion i ri i OJQ-ve***Dy OJQ të Ferizajit formojnë koalicion për demokratizim**

Dy OJQ-të e Ferizajit "Shërbimet Rinore" dhe "1 plus 2" kanë themeluar më 10 janar Koalicionin e Organizatave për Demokraci - KOD. Ky koalicion synon demokratizimin e proceseve politike dhe shoqërore në Ferizaj duke nxitur qytetarët në ngritjen e zërit për nevojat e tyre.

**Mundësi financimi për OJQ-të****Banka Botërore në Kosovë shpalli programin e granteve të vogla për vitin 2007**

*Tema e programit të sivjem të granteve të vogla është arsimiti*

Zyra e Bankës Botërore në Prishtinë ka shpallur në janar Programin e Granteve të Vogla për t'i financuar OJQ-të kosovare, të cilat i përkrahin nismat në arsim përmes përfshirjes së tyre aktive në jetën publike dhe në proceset zhvillimore.

Ky program do ti përkrah aktivitetet, qëllimi parësor i të cilave është angazhimi i shoqërisë civile në fuqizimin e grupeve të shoqërisë civile dhe në avancimin e përfshirjes së një spektri të gjer të nismave të qytetarëve përkritazi me politikat

dhe proceset zhvillimore.

Programi i Granteve të Vogla duhet të shfrytëzohet si ndihmesë në tejkalimin e sfidave lidhur me mundësitë e barabarta në arsim për grupet e rrezikuara dhe në fuqizimin e menaxhimit të shkollave përmes pjesëmarrjes aktive të komunitetit duke i kushtuar vëmendje të posaçme përmirësimit të bërjes së politikave përmes konsultimeve me qytetarët. Programi e plotëson dhe ndihmon agjendën e Bankës Botërore për zhvillim të shoqërisë

duku iu dhënë grante organizatave të shoqërisë civile.

Banka Botërore në Kosovë do të jep grante në shumë prej 5000\$ deri në 10,000\$ në kuadër të Programit të Granteve të Vogla. *Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 28 shkurti 2007.*

Për informata më të hollësishme, vizitoni [www.world-bank.org/kosovo](http://www.world-bank.org/kosovo)

**"Avokimi në praktikë të përkrah barazinë në mes njerëzve"**

*Nga përvoja e aktivistes amerikane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Alice Mead*

ATRC-ja ka organizuar më 12 janar tryezë të rumbullakët ndërmjet aktivistes amerikane për të drejtat e njeriut Alice Mead dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, të emërtuar "Avokimi në Praktikë - nga përvoja e një aktivisteje ndërkombëtare."

Gjatë tryezës, Mead shfaqti filmin e saj dokumentar "Kosova dhe Vdekja e Jugosllavisë" dhe shqyrtoi çështje të avokimit me pjesëmarrësit. Filmi dokumenton shkeljen e të drejtave të shqiptarëve të Kosovës dhe kërkesën e tyre për barazi

regjatë regjimit të ish Kryetarit jugosllav Slobodan Millosheviç. Mead shfrytëzoi këtë film për të avokuar për të drejtat e shqiptarëve të Kosovës gjatë fundit të viteve të 80-ta dhe fillimit të 90-tave.

"Unë nuk jam e lirë, në qoftë se ju nuk jeni të lirë", pohoi Mead në këtë takim. "Liria nuk është vetëm për mua. Nëse të gjithë ne nuk jemi të lirë, atëherë nuk jemi të barabartë. Avokimi është për barazi".

Mead po ashtu ka shkruar librin për Kosovën Adem's Cross dhe përmes avokimit ka kontribuar në lirimet e të burgosurve politik dhe pengjeve të luftës nga burgjet e Serbisë. Mead ka avokuar tek Senati, Kongresi amerikan, dhe organet politike botërore për lirimet e të burgosurve.



*Aktivistja amerikane për të drejtat e njeriut Alice Mead ka avokuar tek Senati, Kongresi amerikan, etj, për lirimet e të burgosurve politik shqiptarë nga burgjet serbe*



**Executive Director**  
RREZE DULI  
rreze@advocacy-center.org

**Financial & Administration Manager**  
GANI ASLLANI  
gani@advocacy-center.org

**Grant Manager**  
TEUTA LUXHA  
teuta@advocacy-center.org

**Grant Officer**  
KUSHTRIM KALOSHI  
kushtrimk@advocacy-center.org

**Grant Officer**  
XHAFER AHMETI  
kushtrimk@advocacy-center.org

**Grant Finance Manager**  
SAFETA XHEKOVIQ  
safeta@advocacy-center.org

**Training & Consultancy Services Manager**  
DONIKA SALIHU  
donika@advocacy-center.org

**Trainer & Consultant**  
AFERDITA SURROI  
aferdita@advocacy-center.org

**Trainer & Consultant**  
KUSHTRIM ISLAMI  
kushtrim@advocacy-center.org

**Trainer & Consultant**  
NORA SUSURI  
nora@advocacy-center.org

**Communication & Outreach Manager**  
ARJETA DOROCI  
arjeta@advocacy-center.org

**Program Officer**  
NATYRA ZHJEQI  
natyra@advocacy-center.org

**IT and Database Manager**  
ARSIM KOSUMI  
arsim@advocacy-center.org

## Debate publike të inicuar nga ATRC-ja

### Pallati i Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë të shërbej për nevojat e të rinjve

ATRC-ja organizoi një tryezë të rumbullakët më 14 dhjetor gjatë së cilës u ngritën çështje si: kujt i shërben Pallati i Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë si dhe gjendja aktuale e të rinjve. Menaxhmenti i Pallatit të Rinisë dhe Sporteve ka mbyllur Qendrën Rinore në këtë pallat më 20 tetor me gjithë kritikën e grupeve rinore.

Gjatë tryezës, përfaqësues të Departamentit për Rini të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, Drejtoratit për Kulturë në Komunën e Prishtinës, Rrjetit Rinor të Kosovës dhe Qendrës Rinore janë pajtuar që Pallati i Rinisë duhet të shërbej për nevojat e të rinjve sikurse edhe për aktivitete të tjera kulturore dhe sportive.



Menaxhmenti i Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë ka mbyllur Qendrën Rinore në këtë ndërtesë më 20 tetor, duke mospërfillur kritikën e grupeve rinore

Menaxhmenti i Pallatit të Rinisë dhe Agjencia Kosovare e Mirëbesimit janë përgjegjëse për gjendjen e krijuar, kanë veçuar ata.

### Qeveria dhe shoqëria civile diskutuan për kthimin e familjeve të zhvendosura në Kastriotit

Përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile diskutuan për të arriturat në kthimin e familjeve të zhvendosura në Komunën e Kastriotit gjatë një debati publik të organizuar nga ATRC-ja më 13 dhjetor në Asamblenë komunale të kësaj komune. Pjesëmarrësit shqyrtuan strategjinë për kthimin e të zhvendosura në shtëpitë e tyre, të përpiluar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Sipas Zëvendës Ministrit për Komunitete dhe Kthim, Ibish Bajramit, kjo ministri ka siguruar kushtet themelore të jetesës për familjet e zhvendosura duke i rindërtuar shtëpitë e shkatërruara. "Ka raste të kthimit të familjeve të zhvendosura në shtëpitë e tyre në Kastriot", ka shtuar ai.

Pjesëmarrësit serb nuk iu besuan përpjekjeve të ministrisë. Ata deklaruan se strategjia e ministrisë është gabim. "Ministria ndërtoi shtëpi, por nuk siguroi asgjë tjetër".

### Shoqëria civile të ngrit vetëdijen e qytetarëve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

Qytetarët e Prizrenit, përfaqësues të OJQ-ve dhe zyrtarë komunal debatuan për çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Prizren gjatë një diskutimi publik të organizuar nga ATRC-ja më 12 janar në Asamblenë komunale të këtij qyteti.

Zëvendës Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Angjelina Krasniqi dhe zëvendës kryetari i komunës së Prizrenit, Erxhan Shpat morën pjesë në këtë takim.



Qytetarët, OJQ-të dhe zyrtarët komunal debatuan më 12 janar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Prizren

Sipas Krasniqit, Ministria e Kulturës ka investuar në vendet historike të Prizrenit aq sa ka pasur mundësi buxhetore. "Degradimi i zonave me trashëgimi kulturore është realitet jo vetëm në Prizren, por edhe në të gjitha komunat e Kosovës", ka shtuar Krasniqi. Ajo u bëri thirrje organizatave të shoqërisë civile që të përqendrohen në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë.